



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja nr. **73/2024**

Data: **31 dhjetor, 2024. Ora: 14:30**

Vendi: **Selia e KQZ**

Kryesues i KQZ-së: Kreshnik Radoniqi.

Anëtarët e KQZ-së: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti,
Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana Llaban, Qemailj

Në takim ishin të Kurtis, Mufera Shinik

pranishëm:

U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP: Besnik Buzhala

Përkthyes: Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Zbatimi i vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. A.nr. 12/2024, i datës 25.12.2024 për miratimin e rekomandimit të Zyrës për certifikimin e subjektit politik SRPSKA LISTA dhe kandidatëve të këtij subjekti politik

3. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi, kryesues i mbledhjes paraqiti agjendën me një pikë të rendit të ditës, dhe të ndryshme. Pastaj, ai e hodhi në votim rendin e ditës.

Rendi i ditës, u votua me 11 vota të anëtarëve.

1. Zbatimi i vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. A.nr. 12/2024, i datës 25.12.2024 për miratimin e rekomandimit të Zyrës për certifikimin e subjektit politik SRPSKA LISTA dhe kandidatëve të këtij subjekti politik:

Kreshnik Radoniqi: Lidhur me mos certifikimin e kandidatëve të subjektit Lista Serbska, PZAP ka marrë vendim me të cilin vendim, e ka urdhëruar KQZ-në ta certifikojë Listën Serbska dhe kandidatët e saj. Ky vendim është apeluar dhe Gjykata Supreme ka marrë vendim dhe e ka hedhur poshtë si të palejuar ankesën e subjektit politikë Lëvizja “Vetëvendosje!” Me këtë vendim të supremes, vendimi i PZAP-së është i plotfuqishëm. Prandaj, sipas nenit 118, paragrafi 5 vendimet e PZAP-së janë të obligueshme për KQZ-në. Unë mendoj, tha z. Radoniqi se kjo çështje është e mbyllur duke u certifikuar ky subjekt.

Sami Kurteshi: I kam pa vendimet, dhe ato janë jo të plota sepse nuk janë marrë parasysh faktet, dëshmitë dhe dokumentet: “Deklarata politike” dhe “Kodi i mirësjelljes”. Në këto dokumente, ka shumë elemente që nuk janë marr parasysh as nga PZAP dhe Gjykata Supreme, dhe unë mendoj se ka elemente. Unë, personalisht e kam fjalën te dhuna që është organizuar, motivuar dhe zhvilluar nga ky subjekt.

Në vazhdim, z. Kurteshi bëri një rezymë lidhur me aktivitetet, sjelljet e dhunshme dhe veprimeve të tjera në komunitat në veri, ashtu si edhe veprimet e tjera organizative që nga zgjedhjet lokale të vitit 2023, protestat e dhunshme etj. KQZ nuk i ka ndërmarrë sanksione edhe pse, në zyrat e KQZ në komunitat me shumicë serbe në veri kanë futur eksploziv. Së paku një ish zyrtar i lartë i listës serpska, e ka pranuar se organizuar aksione terroriste me armë...

Ky subjekt politik, tha z. Kurteshi nuk meriton të certifikohet. Unë, jam kundër...!

Alban Krasniqi: Nëse jemi te vendimi – arsyetimi i PZAP, ajo i referohet Nenit 16 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Unë, e kam kundërshtuar dhe i referohem pikërisht këtij neni. Pika 5.6 dhe 5.7 e përshkruan qartësisht obligimin që një subjekt ka me e nënshkruar dhe me e zbatuar kodin e mirësjelljes.

Pika 13 e nenit 16, i jep të drejtë KQZ-së ta anulojë certifikimin e një subjekti, nëse subjekti nuk i përmbush kriteret. Prandaj, e ftoj edhe Blerim Isufajn, kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale sepse i ka videot ku lista srpska përdorë shprehje, terme që nuk janë të lejueshme... Por, as ai dhe as PZAP, as Gjykata Supreme nuk e ka guximin me u marrë me këtë subjekt. Dhe a e dini pse, sepse është pikërisht zonja Daka, ish kryetare e KQZ-së që përmes bisedimeve në Bruksel, dhunshëm bashkë me anëtarët e tjerë të KQZ-së, bashkë me diplomatët e kanë sjellë nën rrogë këtë subjekt paramilitarë në atë kohë. Sot, ne kërcënohemi nga po ky subjekt. Askush, nuk reagon.

Çka është puna me këto institucione...?

Votë, nga ana ime, nuk merrë ! Edhe sot kur flasim, kjo organizatë edhe kundër komunitetit serb e ka shtri terrorin. Presidentja, frikë pat deklaratë dhe deklarata e saj, ishte edhe për prokurorinë. Çka thotë zonja Osmani: “Lista Serbe, është e angazhuar në akte terroriste”! Edhe zonja Biserko, aktiviste në Beograd që thotë qartë se Lista Serbe, është përgjegjëse për krizën në veri”.

Ka dëshmi të panumërta, tha z. Krasniqi që, solli në diskutimin e tij edhe fakte tjera, përvoja zgjedhore dhe, një histori mbi terrorin dhe dhunën në veri që e ka zhvilluar e udhëhequr Lista Serbska me strukturat e saj militare e paramilitare.

Iliri Gashi: Thënë drejt, pajtohem me shumë atë që u tha nga parafolësit. Po, e dimë dhe qëndrojnë këto që u than. Po të varej nga ne, ndryshe do ishte por, ne s’kemi mundësi të vendosim përtej gjyqësorit! Në bazë të ligjit, ex officio, subjektet janë të certifikuara. Por ne po flasim për kandidatët. Është befasues fakti se, institucionet, asnjëra nuk na ka sjellë dokumente, vendime që ne, do të kishim vendosur mbi jo ligjshmërinë e atyre personave që janë të përfshirë në krime në mënyrë që ne, të kishim vendosur ndryshe. Pra, nuk është provuar jo ligjshmëria! Më kujtohet kur qeveria më 20 qershor 2023, me të drejtë ka shpallur dy organizata si terroriste. Pse nuk e ka bërë edhe në rastin konkret ? Më duket sikur politika zhvendoset nga aty ku duhet, aty ku nuk duhet. Unë kam pritur që do të kemi dëshmi, fakte që personat e caktuar janë të paligjshëm. Nuk e ka bërë asnjë institucion...

Unë, po e përmbylli: unë pres që qeveria, institucionet të marrin vendime që do ta vërtetonin jo ligjshmërinë e këtyre personave.

Gordana Llaban: Ju përshëndes të gjithëve, dhe...

Alban Krasniqi: Një parti politike, dihet kush e shpall terroriste. Nuk e shpallë as qeveria, as ministria. Kjo, është propaganda juaj...

Gordana Llaban: Ju lutem, ne ti kthehem punës sonë. Puna jonë, nuk është që ne të merremi me punën e prokurorisë, të policisë, të inteligjencës. Pse të përplasemi për vendimet e institucioneve të caktuara, pra secili të bëj punën e tij. Ne nuk jemi parlament që të debatojmë...

Alban Krasniqi: Z. Gashi, e di mirë se të gjitha ato institucione që i përmende, u kan shkuar informacionet. Dhe, vazhdimi i aktiviteteve të listës serbe në këtë mënyrë, e cenon sigurinë në vendin tonë. Me i mbyllë sytë para fakteve që ne ofrojmë, ky është fundi dhe e tregon fytyrën e tyre të vërtetë..

Arianit Elshani: Në KQZ, nuk ka kalue certifikimi i Listës Serbe. Ka qenë krejt e qartë që, nuk është vullneti i KQZ-së me e certifikue listën serbe. Këtu, nuk ka kalue certifikimi. Dhe ne, kemi pritë deri sot që të kemi përgjigje nga MPB dhe institucionet e tjera të sigurisë. Prandaj, ky debat është politikë sepse, nuk është kompetencë e jonë përgjegjësia e organeve të tjera.

Ibrahim Selmanaj: Nuk është momenti të fshihemi para realitetit. I kemi organet që do të mund ta kishin sjellë një vendim, a diçka tjetër që të kishim vendosur ndryshe. Prandaj, nuk është e mirë me i sulmue mekanizmat e shtetit, PZAP-në, Gjykatën Supreme etj. Shteti, ka nevojë të përkrahet. Vendimet që sillen duhet përkrahur...

Sami Kurteshi: Unë, lojalitetin tim politik dhe partiak e kam në Vetëvdosje. Lojalitetin profesional, e bëj në KQZ. Unë baj politikë. Këtë dallim duhet me ba. Vendimi i PZAP dhe i Gjykatës Supreme, është i pjesërishëm, unë e shpjegova. Aty, është kodi i mirësjelljes që, duhet nënshkruar me të cilin ndalohet dhuna, kërcënimet.... Dihet pse...

Ky subjekt, madje, ka sulmuar zyrat tona me eksploziv, drejtorët nuk i kanë hapur shkollat për votim. Ky subjekt, ka shpallë ditë zie për personat që kanë marrë pjesë në sulme terroriste kundër Kosovës...

Unë, jam kundër certifikimit.

Kreshnik Radoniqi: Nëse nuk ka dikush tjetër me fol, unë konstatoj se vendimi i PZAP-së është i detyrueshëm për ne, dhe unë do ta lëshoj një vendim për zbatimin e vendimit të PZAP-së...

Alban Krasniqi: Çka është kjo, si certifikohet, kush e certifikon...? Ky, është atak mbi institucionet... Qe, si sulmohen institucionet...

3.Të ndryshme !

